

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Sh. LL. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson J. R., av.nga Prishtina, kundër të paditurës NPK “Termokos” në Prishtinë,të cilën e përfaqëson N. H. av.nga Prishtina, në çështjen juridike të anulimit të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke vendosur përkritazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2516/2013 datë 20.10.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.10.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit Sh. LL., nga Prishtina, paraqitur kundër Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2516/2013 datë 20.10.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës,Ac.nr.2516/2013 datë 20.10.2015,është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1.nr.486/2007 datë 26.9.2012, me të cilin në pjesën I. të dispozitivit, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. LL., nga Prishtina, për anulimin e vendimit të paditurës NPK “Termokos” në Prishtinë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij, nr..., datë 04.11.2003, si dhe detyrimin e të paditurës që paditësin ta kthejë në punë, në vendin e punës

sipas përgatitjes së tij profesionale, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës. Me pjesën II. të dispozitivit, është vendosur që ndërgjyqësit t'i bartin vet shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, revizion me kohë ka paraqitur paditësi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen, të miratohet kërkesëpadia e paditësit apo të priset dhe çështja t'i kthehet për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se :

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padinë e tij të datës 12.12.2003, pretendon se e paditura me vendimin nr.962 datë 04.11.2003, në mënyrë të kundërligjshme ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Është jo kontestues fakti se paditësi, në kohën e pas luftës në vitin 2000, ka qenë i emëruar si UD Drejtor i Ndërmarrjes së paditur por që për këtë pozitë e paditura ka shpallur konkurs të veçantë ,sipas të cilit për pozitën e drejtorit të kësaj ndërmarrje është zgjedhur personi tjetër B. I., dhe atë nga shtatori i vitit 2002. Më pas paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas vendimit të Bordit Ekzekutiv të të paditurës nr..., i datës ..., i marrë në mbledhjen e datës 02.09.2003, me arsyetim se ai nuk është paraqitur në punë nga data 25.03.2003, e deri në ditën e marrjes së këtij vendimi përkatësisht me datën 02.09.2003, për kundër faktit se të gjithnjë punëtorëve të të paditurës publikisht iu është tërhequr vërejtja për pasojat e mungesës së paarsyeshme nga puna. Në këtë çështje juridike si fakt kontestues është paraqitur fakti se a është paraqitur me rregull në punë paditësi apo jo gjatë kohës kontestuese nga data 25.03.2003, e deri më datën 02.09.2003.

Gjykata e shkallës së parë, pas zhvillimit të procedurës kontestimore, për herë të parë, me aktgjykimin C1.nr.429/2003 datë 19.05.2005, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, por ky aktgjykim është prishur sipas ankesës së paditësit, me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.109/2006 datë 02.11.2007, dhe çështja është kthyer në rigjykim për tu vërtetuar fakti se gjatë periudhës kontestuese nga data 25.03.2003 e deri në ditën e marrjes së vendimit kontestues me 04.11.2003, a është paraqitur me rregull paditësi në punë dhe detyrat e

punës apo jo. Në rigjykim të çështjes gjykata e shkallës së parë duke përfillur vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë ka vendosur sinë dispozitiv të aktgjykimit, sërish duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimimit ka pranuar si të vlefshëm përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Në mbështetje të gjendjes së përshkruar të çështjes kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë argumente të mjaftueshme në mbështetje të konstatimit të saj lidhur me aktgjykimin e goditur. Faktet të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së dytë nuk vihen në pyetje në thëniet në revizion, provat tjera të analizuar më hollësisht nga gjykata e shkallës së dytë e materializojnë konstatimin e asaj të fundit në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit. Kjo nga fakti se, paditësi ka dështuar ta argumentojë me fakte në favor të tij, se është paraqitur me rregull në punë gjatë kohës kontestuese nga data 25.03.2003, e deri më datën 02.09.2003. Sipas dispozitës së nenit 8 të LPK, palët janë të detyruara që të paraqesin fakte mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat vërtetohen ato fakte. Rregulla mbi barrën e provave, me këtë dispozitë i bie paditësin. Për faktin se në rastin konkret paditësi këtë nuk e ka bërë, e nga provat e administruara nuk mund të vërtetohet në mënyrë të sigurt ekzistimit i fakteve mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia e paditësit e as provat në të cilat vërtetohen ato fakte në kuptim të dispozitës së nenit 223 të LPK. Gjykata e shkallës së parë, nga provat e marra, nuk ka mund të konstatojë me siguri faktin se paditësi a është lajmëruar me rregull në punë tek e paditura gjatë kohës kontestuese.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për faktin se, nuk janë vlerësuar faktet relevante lidhur me meritat e lëndës që i referohen obligimit të paditësit për tu lajmëruar në punë, pa u sistemuar

në vendin e punës, parashtrimet e tilla kjo Gjykatë i cilësoj si pa ndikim në meritat e lëndës pasi që, objekt i shqyrtimit në këtë kontest është vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit mbi ndërprerje së marrëdhënies së punës së paditësit e jo sistemimi i tij. Paditësi nuk ka provuar faktin se ka parashtruar kërkesë tek e paditura lidhur me sistemimin e tij në punë tjera jashtë postit udhëheqës të drejtorit-sipas përgatitjes së tij profesionale si dhe realizimin e të drejtave tjera që dalin nga marrëdhënia e punës dhe për lëshimet e veta, paditësi nuk mundë ta fajësoj të paditurën.

Parashtrimet në revizion se gjykata e shkallës së dytë, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, nuk e ka marrë bindëse dhe të bazuar deklaratën e dëshmitares F. B., nga Prishtina, e cila aso kohe ka qenë asistente e drejtorit të ri Bashkim Ibrahim, për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me paraqitjen e paditësit në punë, kanë qenë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi i të dy gjykatave ku janë dhënë arsyet faktike dhe juridike lidhur me këto parashtrime e që janë të pranueshëm edhe për këtë Gjykatë pa pas nevojë që të përsëriten .

Mbi këtë bazë kjo gjykatë i cilësoi si të papranueshme parashtrimet në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale për çka vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Mbi bazën e të dhënave të cekura si më lart e me zbatimin e dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.269/2016 më 04.10.2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani

.